



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE**  
**INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**



**KPM V2-2015**

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave Nr. 04/L-44/02, përkatësisht në nenin 23, paragrafi 4, në mbledhjen e mbajtur me datën 24 shkurt 2015, merr këtë:

**VENDIM**

- I. Zgjatet afati për 30 ditë për vendosje lidhur me dhënien e licencave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t'u pajisur me licencë për shërbimet mediale Radio.
- II. Obligohet Zyra Ekzekutive që në pajtim me nenin 23, paragrafi 4, të Ligjit të KPM-së t'i njoftoj të gjithë kandidatët dhe publikun për zgjatjen e afatit dhe arsyet për këtë.

**ARSYETIM**

- III. KPM, me datën 26 dhjetor 2014, ka shpallur konkursin publik për dhënjen e Frekuencave te reja për shërbimet mediale radio, i cili ka qenë publik deri me datën 26 janar 2015.
- IV. Bazuar në nenin 23 të Ligjit të KPM-së, KPM-ja brenda tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të datës për aplikim vendos se a do t'ia lëshoj licencën një kandidati.
- V. Komisioni në mungesë të kuorumit (pasi që dy anëtar të Komisionit kanë qenë jashtë vendi) nuk ka mundur të vendos lidhur me dhënjen e licencave brenda afatit 30 ditor, prandaj KPM duke u bazuar në nenin 23, paragrafi 4, të Ligjit të KPM-së vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Adnan MEROVCI

  
Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave

data

26.02.2015